Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**11.09.2023**	**25.09.2023**	**2023/0647**
Eksperti Teknik **Donijeta Sogojeva**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **12.09.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.09.2023, OE “" BE NEW " L.L.C.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0647, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Qendra mobile per kontrollim teknik te automejteve ne rruge.” me nr. të prokurimit: "205-23-6058-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E INFRASTRUKTURES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 500,000.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 13.06.2023; data e hapjes së ofertës: 28.07.2023, data e njoftimit mbi vendimit e AK-se: 17.08.2023, data e njoftimit të me letër standarde:17.08.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

NENI 1;6;13 59; 60 , 65 dhe 69.

KRITERET PËR VLERËSIM

a) Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 . b) Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës . c) Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës . d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare a) Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi 2 . b) Vërtetim nga Administrata Tatimore . c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – original kopje . d)Vërtetimin nga Gjykata Themelore – original ose kopje .
Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe Autoritetit Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

a) Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës)

b) Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore)

a) Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit

b) Kopja e certifikatës së TVSH-së

Kapaciteti ekonomik dhe financiar 1. OE duhet te ofroj dëshmi se qarkullimi vjetor i OE gjate 3 viteve te fundit (2020, 2021 dhe 2022) ka qene ne vlere jo me pak se 800,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit.

1. Menaxheri i Projektit (personi kontaktues) 2. Lista e kontratave te realizuara dhe perfunduara për periudhën e shkuar tre vjeçare (2020, 2021 dhe 2022) jo më pak se 700,000.00 € . 3.Katalog ose broshure me ilustrime foto dhe me përshkrim detal te pajisjes me te cilën mundësohet vlerësimi i specifikave teknike të ofruara . 4. Projekti i detajuar i cili permban te gjitha pajisjet, se si duket nje qender mobile dhe si do te funksionoj.

Dëshmia e kërkuar dokumentare Deshmia 1 - CV e nenshkruara nga inxhinieri, kontrata e punës me ofertuesin . Deshmia 2. Kopje te kontratave dhe Procesverbalet e pranimit përfundimtar të pajisjeve, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve te realizuara per periudhën e shkuar tre vjeçare, te shoqruara me referenca dhe proqesverbale te pranimit te pajisjeve. 3.Katalog broshure me detajet e nevojshme për vlerësim. 4. Deshmija 4.- OE duhet te prezantoj një projekt detaj se si do te funksionj kjo qender mobile per realzimin e qellimit te ketij projekti.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontrate eshte përgjegjshëm.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" BE NEW " L.L.C.**

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin AK-se, ka parashtruar ankese kundër vendimit per dhënie te kontratës, me pretendimin se AK-ja, nuk i a respektuar procedurat e vlerësimit te ofertave.

Autoriteti kontraktues, pas përfundimit te vlerësimit te ofertave e ka njoftuar OE ankues me rezultatin e vlerësimit te cilin e eliminon me arsyetimin se:

CV-ja e menaxherit të projektit nuk është e nënshkruar nga inxhinieri, e cila ka qene kërkesë e dosjes se tenderit dhe arsyeja tjetër e eliminimit te OE ankues është i njëjti sipas AK-se se ka ndërhyrë ne formularët standarde te aprovuar nga KRPP-ja, ku OE ankues deklaratën e themelimit te grupit te cilën e ka dorëzuar e ka emëruar si anexi 6 e qe sipas AK-se është pjesa e kritereve për dhënie te kontratës.

Sa i përket arsyetimit te AK-se, se CV-ja e menaxherit është pa nënshkruar, eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ofertën e tij e ka dorëzuar CV-in e menaxherit të panënshkruar dhe për te njëjtën dëshmi AK-ja ka kërkuar ne dosje te tenderit qe te jet e nënshkruar. Eksperti shqyrtues vlerëson se ne raport me çmimin e dhënë kjo mund te konsiderohet si devijim i vogël dhe se për vërtetësinë e këtij dokumenti AK-ja ka mundur te sqarohet ne baze te nenit 72 te LPP-se, për faktin se nënshkrimi vërteton vetëm vërtitësin e atij dokumenti ndërsa dëshmitë tjera te prezantuara ne CV e plotësojnë kërkesën e AK-se.

Lidhur me arsyen e dyte te eliminimit, eksperti shqyrtues pasi ka analizuar dëshmitë e dorëzuara nga OE ankues, vlerëson se nuk mund te eliminohet për ate arsye sepse vetëm e ka emëruar dokumentin si ANEXI 6 – deklarate e themelimit te grupit dhe nuk mund te konsiderohet nderhyrje ne formularin e KRPP-se.

OE ankues, ne ankesën e tij pretendon se AK-ja, ka rekomanduar për kontrate një OE te papërgjegjshëm. OE ankues pretendon se anëtari konzorciumit te OE te rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar disa dëshmi te cilat janë ne kundërshtim me nenin 13 te LPP-se, sepse i ka dorëzuar te përkthyera por qe nuk kanë vule te përkthyesit zyrtar. Eksperti shqyrtues sqaron se dëshmit te dorëzuara janë te përkthyera ne gjuhen angleze, pra sipas nenit 13 te LPP-se, ndërsa lidhur me mungesën e vulës se përkthyesit zyrtar, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk mund te eliminohet sepse nuk ka qene kërkesë e dosjes se tenderit. Prandaj, ky pretendim nuk qëndron.

OE ankues poashtu pretendon se i rekomanduari për kontrate ka dorëzuar fatura ne gjuhen maqedone ne versionin cirilik. Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim nuk qëndron se faturat përveç qe janë ne gjuhen Maqedone janë edhe ne gjuhen angleze.

OE ankues, pretendon se konzorciumi i rekomanduar për kontrate nuk i ka dorëzuar kontratat dhe referencat sipas kërkesës se dosjes se tenderit, me arsyetimin se anëtari konzorciumit ka dorëzuar kontrata ne gjuhen Maqedone dhe poashtu i ka përmendur disa kontrata për te cilat nuk ka dorëzuar fare referenca.

Eksperti shqyrtues, lidhur me kete pretendim sqaron se, nuk qëndron per faktin se pas analizimit te shkresave te lendes ka vërejtur se vetëm lideri i konzorciumit i ka dorëzuar kontratat dhe referencat ne vlere mbi 700,000.00 euro, ku kerkese e dosjes se tenderit ka qene: Lista e kontratave te realizuara dhe te përfunduara per periudhën e shkuar tri vjeqare 2020, 2021 dhe 2023, jo me pakse 700,000.00 euro. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se konzorciumi ne fjale ka dorëzuar kontrata dhe referenca sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Poashtu sa i përket pretendimit te OE ankues, lidhur me borxhet e pashlyera ne ATK, te OE te rekomanduar për kontrate, eksperti shqyrtues, sqaron se i rekomanduari për kontrate ka marrëveshje me ATK, per shlyerjen e borxheve, andaj dhe mbi bazën e praktikave te deritashme te OSHP, nuk mund te eliminohet nje OE i cili ka marrëveshje pers lyerjen e borxheve.

Eksperti teknik:

Pretendimi ankimor i OE ankues i cili deklaron se OE fitues nuk ka paraqitur projektin e detajuar i cili i përmban te gjitha pajisjet , se si duket një qendër mobile dhe si do te funksionoj por ka paraqitur vetëm dimensionet e kontrolles mobile dhe disa fotografi te kontrolles dhe ky dokument nuk ka te bëjë fare me projektin e detajuar ,pasi qe ne këtë dokument nuk është paraqitur asnjë detaj i vetëm pajisjeve te instaluara dhe funksionimi i pajisjes .

Eksperti teknik, sqaron se pretendimi ankimore është i bazuar sepse OE fitues nuk ka ofruar Projektin e detajuar sipas kerkeses se dosjes se tenderit " 4. Deshmija 4.- OE duhet te prezantoj nje projekt detaj se si do te funksionj kjo qender mobile per realzimin e qellimit te ketij projekti.".

Pretendimi ankimor i OE ankues i cili deklaron se OE fitues nuk ka dëshmuar asnjë dokument apo deklarate te konfirmitetit (CE) për pajisjet qe ka ofertuar d.m.th. nuk ka prezantuar asnjë dokument qe konfirmon se pajisjet e ofertuar janë ne përputhje me rregullat e BE-se ashtu siç është kërkuar nga AK ne sqarimin e fundit .

Eksperti teknik sqaron se pretendimi ankimore eshte i bazuar lidhur me Deklaraten e konformitetit te kerkuara nga AK ne dok. Sqarimet ne pytjet e parashtruara nga OE:

"Për neve është e mjaftueshme deklarata e konformitetit me të cilën sigurohet cilësia e kërkuar. Sipas Ligjit nr. 05/L/132 Për automjete certifikata e konformitetit duhet të jetë sipas kërkesave të Bashkimit Europian.

Pra, pradukti i cili posedon certifikatë të konformitetit (produket i dedikuar për vendet anëtare të BE – së) i plotëson kushtet e kërkuara sipas këtij tenderi".

Pretendimi ankimor i OE ankues i cili deklaron se OE fitues i mungon Prezantimi i certifikatës pa deklarate mbështetëse qe konfirmon se pajisjet e ofertuar do te kalibrohen nga një laborator i akredituar, nuk është e mjaftueshme dhe bindëse për AK se pajisjet e ofertuar do te jene te kalibruara vetëm përmes prezantimit te certifikatës se akreditimit për kalibrim te pajisjeve.

Eksperti teknik: Pretendimi ankimor është i pabazuar sepse nuk është kërkuar dokument mbështetës për verifikim te kalibimit pajisjeve ne kërkesat e specifikacionit teknik por vetëm thuhet se:

Të gjitha pajisjet që kryejnë matje duhet të posedojnë certifikata të kalibrimit nga një laborator kalibrues të akredituar sipas standardit ISO 17025, organi i akreditimit të të cilit është nënshkrues i Marrëveshjes Evropiane të Akreditimit EA MLA dhe i Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Akreditimin e Laboratorit ILAC MRA.

Pretendimi ankimor i OE ankues i cili deklaron se OE fitues ka prezantuar certifikatën e kalibrimit për kompaninë e vet si trup certifikues e cila është ne kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe është konflikt interesi pas qe nuk munde te jesh furnizues edhe njëkohësisht trupe e akredituar për kalibrim për pajisjet qe i oferton. Për ilustrim për te pasur me qarte psh një kompani qe shtron asfalt nuk lejohet dhe nuk pranohet qe te beje vete analizat e asfaltit , por duhet një trupe e pavaruar qe te beje analizën e asfaltit . Laboratori i akredituar është trup e pavarur dhe ne rastin konkret është konflikt i hapur qe vetvetes t'ia beje kalibrimin e pajisjeve!?.

Eksperti teknik: Pretendimi ankimore është i pabazuar, sepse OE i rekomanduar për kontrate është ne konzercium ne ketë aktivitet te prokurimit me Laboratorin AUTOINSTRUMENT DOOEL i cili është i akredituar MKS EN ISO/IEC 17025 : 2018 nga Instituti per Akreditim ne Republiken e Maqedonise Veriore

Pretendimi ankimor i OE ankues lidhje me arsyetimin e ofertës Profitech&VAMAG , AK ka patur te drejte për arsyen e eliminimit, por ka edhe mungesa te tjera tejet te rëndësishme qe ky OE nuk i ka

përmbushur kërkesat e dosjes se tenderi dhe ato janë:Qëndron ne tërësi arsyetimi i AK për eliminim te ofertës Profitech&VAMAG ,pasi ky konzercium nuk ka paraqitur dizajnin grafik te kontrolles teknike mobile ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit.Produkti i ofertuar nga konezrciumi Profitech&VAMAG , nuk i plotëson kërkesat e dosjes pasi qe produkti shihet qarte se nuk është e tipit kontejner termik (ne baze te fotove shihet qe produkti është i hapur) si dhe gjeneratori nuk është pjese e kontejnerit por është i ndare dhe kjo është ne kundërshtim me kërkesat e specifikave teknike pasi qe është kërkuar qe njësia mobile me qene e integruar dmth një njësi - kontejner .

Eksperti teknik: Pretendimi ankimor është i pabazuar sepse OE Profitech&VAMAG ka ofruar kontenjerin termik dhe se gjeneratori është intergruar ne shasin mobile.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" BE NEW " L.L.C.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Florije Rexhepi

Donijeta Sogojeva

Sogojeva